

VENDIMI PER KONTROLLIN DOSJA ZVERNECIT.

REPUBLIKA SHQIPERISA

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Nr. 410 Regj. Them.

Datë regjistrimi 31.05.2026

Nr. 410 Vendimi Datë vendimi 31.05.2026

VENDIM

"LEJIM KONTROLLI VENDI DHE PERSONI"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTARE-FLOJERA DAVIDHI

Sot më datë 31.05.2026, ora 14:30, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, në cilësinë e gjyqtares së hetimeve paraprake, çështjen penale me nr.410 regj. them., datë regjistrimi 31.05.2026, që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar sipas kërkesës nga prokurorët Altin Dumani dhe Elida Kaçkini.

OBJEKTI:

Lejim kontrolli vendi dhe personi.

BAZA LIGJORE:

Nenet 52, 202, 203, 204, 205 dhe 206, 208/a të K.Pr.Penale.

Gjykata, në zbatim të nenit 222/4 të K.Pr.Penale pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi¹ kërkesën penale nr. regj.them. 410, datë regjistrimi 31.05.2026, si shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi,

VËREN SE:

I.Procedura

Kërkuesi, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim

referuar si Gjykata ose Gjykata e Posaçme) kërkesën penale për lejimin e kontrollit të vendeve dhe personave.

Faqa 2

II. Rrethanat e faktit të referuar

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprat penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 287/1, 28/4, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal.

Hetimet e zhvilluara

Nga hetimet që po zhvillon në mënyrë dinamike në lidhje me disa veprime dhe transaksione të kryera përgjatë fundit të vitit 2025 e në vitin 2026 janë konstatuar veprime në lidhje me tjetërsimin e disa pasurive të paluajtshme, sipërfaqe toke, të ndodhura në zonat Akërnj/Zvërnec, Vlorë.

Në lidhje me këto pasuri ka konflikte të hershme dhe të vazhdueshme në kohë, ndërmjet disa personave, banorë të zonës, të cilët pretendojnë përfitimin të këtyre sipërfaqeve me anë AMTP-ve, ndërkohë që sipërfaqet e tokës rezultojnë të regjistruar në Agjensinë e Kadastrës, në emër fillimisht të trashëgimtarëve të shtetasit Artur Shehu, dhe më pas në emër të këtij të fundit (i cili rezulton ndër të tjerë t'i ketë blerë ato nga trashëgimtarët) dhe në emër të shtetasit Ferdinant Sulaj, trashëgimtar i shtetasit Seit Shehu. Një pjesë e këtyre pronave janë tjetërsuar tek shtetasi Pullumb Petritaj, i cili rezulton të ketë qenë përfaqësues i shtetasit Seit Shehu në proceset gjyqësore dhe administrative për regjistrimin e pasurive.

Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezultojnë se, konfliktet janë akoma në procese gjyqësore duke mos patur vendimmarrje të formës së prerë, ku edhe për pasurinë me nr. 262, zona kadastrale 1007 vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka shërbyer për regjistrimin e pasurive është prishur nga Gjykata e Lartë. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve gjyqësore citohen edhe dokumenta të përdorur përgjatë proceseve të cilat kanë rezultuar të falsifikuara. Gjithashtu, në krijimin e dyshimeve në lidhje me mënyrën e marrjes së këtyre pronave, mbahen parasysh edhe dosje gjyqësore dhe çështje të tjera, ku shtetasi Pullumb Petritaj është dënuar dhe ka patur procese të shumta të shumta gjyqësore në lidhje me falsifikim të dokumentave për prona që lidhen me shtetasin Artur Shehu, me të njëjtën mënyrë të vepruari. Gjithashtu, ai është në proces gjyqësor dhe për përdorim të dokumenti të falsifikuar në lidhje me këto prona, referuar vendimit me nr. 151, datë 27.06.2024 të Gjykatës së Lartë.

Neni 222/4 i K.Pr.Penale parashikon se: "Ne rastet e parashikuara në paragrafet 1, 2 dhe 3, të këtij neni, gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit....". Vendim nr. 348, 06.10.2022 i Gjykatës së Lartë.

Faqe 3

Ndodhur para këtyre rrethanave, marrë parasysh mënyrën e të vepruarit nga personat në regjistrimin e pronave (ku rezultojnë aplikime dhe veprime të shpejta në regjistrimin e pronave) si dhe pas regjistrimit duke patur një sërë veprimesh shitjesh, shkëmbimesh, me përfitues shtetasit Artur Shehu, ku në emër dhe për llogari të tij vepron shtetasi Leonard Bishaj, Pullumb Petritaj e Enkes Hysendhima, veprim të cilat janë të planifikuara dhe të koordinuara me pjesëmarrje aktive të personave të tjerë (referoju deklarimeve të dhëna nga shtetasit Soni Sulaj dhe Amela Mukaj), të cilët kanë ndërmjetësuar dhe kanë ndjekur këto veprime me pjesëmarrje dhe interes të shtuar, pa patur të paktën deri tani një interes që rrjedh nga marrëdhënie juridike të caktuara, krijohen dyshime të arsyeshme për kryerje të veprave penale "Pastrim i produkteve të veprës penale" kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 287 e 28/4, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal.

Këto dyshime mbështeten edhe në të dhënat si më poshtë vijon:

Shoqëria "Albania Land Development" sh.p.k. me Nipt M567272081, adm Redi Struga, në datën 25.03.2026 ka lidhur një kontratë sipërmarrje me "Zverec South Adriatic Development", me Nipt M42013024Q.

Në datën 28.05.2026, në zbatim të vendimit të prokurorit për këqyrjen e marrjen e dokumenteve

nga zyra e noteres Amela Mukaj, janë marrë kontratat:

1. Kontrata me nr. 2562 rep., dhe nr. 1497 kol., e datës 24.05.2026;
2. Kontrata me nr. 2060 rep., dhe nr. 1164 kol., e datës 24.04.2026;
3. Kontrata me nr. 2062 rep., dhe nr. 1166 kol., e datës 24.04.2026;
4. Kontrata me nr. 2061 rep., dhe nr. 1165 kol., e datës 24.04.2026;
5. Kontrata me nr. 1964 rep., dhe nr. 1117 kol., e datës 21.04.2026;
6. Kontrata me nr. 5210 rep., dhe nr. 2784 kol., e datës 09.12.2025;
7. Kontrata me nr. 4958 rep., dhe nr. 2633 kol., e datës 21.11.2025;
8. Kontrata me nr. 4956 rep., dhe nr. 2631 kol., e datës 21.11.2025; 9. Kontrata me nr. 4957 rep., dhe nr. 2632 kol., e datës 21.11.2025.

Me procesverbalin e datës 28.05.2026, është marrë deklarimi i shtetases Amela Mukaj lidhur me veprimet që ajo ka kryer për kontratat e mësipërme dhe ajo deklaroi se lidhjen me palët e kontratave sa më sipër ia ka mundësuar shtetasi Edgers, i cili është i punësuar në një nga shoqëritë e Kastrati Group. Nga kjo shoqëri, shtetasja Amela Mukaj deklaroi se ka patur dhe komunikime me një shtetase me emrin Sara Banushi. E pyetur nëse i ka të ruajtura komunikimet me shtetasen Sara Banushi, ajo u shpreh se i ka fshirë. Në vijim, me procesverbalin e datës 28.05.2026, pas dhënies së pëlqimit të shtetases Amela Mukaj, ka nisur këqyrja e aparatit celular që ka qenë në përdorim nga kjo e fundit. Këqyrja ka nisur në zyrat e Prokurorisë së Posaçme, por është ndërprerë pasi shtetasja ka vendosur që këqyrja të mos vijojë më tej. Nga analiza e këqyrjes së pjesshme, ka rezultuar me interes se Amela Mukaj ka patur komunikime me numrin e telefonit 355 67 206 0666, që përdoret nga shtetasi Enkes Hysendhima. Komunikimi mes shtetasve Amela Mukaj dhe Enkes Hysendhima ka nisur në datën 10.09.2024 dhe komunikimet lidhen kryesisht me akte shit-blerje pronash në zonën e Vlorës. Në datën 10.11...025 ora 12:36:54 PM Enkes Hysendhima i shkruan Amela Mukaj "Jane 4 kartela per tu rifresku 1. Artur shehu dhe Ferdinand sulaj bp zk 3951 2. south adriatic zk 1097 3. ferdinand sulaj 9400 m2 zk 1007 4. am nvest 25.000 m2 zk 1007". Në datën 13 11.25, ora 1:07:10 PM Enkes ilyandhima i dërgon një kontratë shkëmbimi me nr. rep. 2145 ale nr. kol. 771, ku Feriare Petruoj shkëmben 2000m2 ayll të ndodhura në ZK 8604 me 112.000 m2 të Raimon Mëzit.

Faqa 4

Në vijim Enkes Hysendhima shkruan "Kjo eshte menyra e fitimit te pronesise se ferlares per 78.000 m2. Menyra e perfitikit te siperfaqer se mdhe qe eshte ne bp Ash dhe F.S eshte goxha kontrate e madhe shkembimi mix me pjestaret e tjere te fisit... por si origjine prone eshte vendim komisioni".

Gjithashtu, komunikimi mes shtetasve konsiston edhe lidhur me kontratat që shoqëria "Albania Land Development" ka bërë me shtetasit Artur Shehu, Ferdinand Sulaj etj.

Në datën 29.05.2026 është bërë marrja në pyetje e shtetasit Ferdinand Sulaj, i cili deklaroi se lidhur me fitimin e pronësisë së pasurisë me nr. 1/1, të ndodhur në zonën e njohur si Dalani, Zvërnec, është kthyer me vendim të kthimit dhe kompensimit të pronave në emër të Ramis Shehut, Merjeme Shehut dhe Kutbi Shehut (nipër dhe mbesa e Seit Shehut). Me procesin e kthimit të pronave dhe regjistrimin e tyre është marrë Artur Shehu, nëpërmjet përfaqësuesit të tij në atë kohë Pullumb Petritaj. Rreth vitit 2007 prona e Dalanit, me sipërfaqe prej 1,089,150 m² u regjistrua në emër të Ramisit, Merjemes dhe Kutbiut, të cilët ishin të tre gjallë në atë kohë. Më pas, këto të fundit ua shitën pronën trashëgimtarevë të tjerë të Seit Shehut dhe Ferdinand Sulaj, i takonte të merrte pjesën 1/15. Për shkak të një marrëveshje që kishte rënë dakord me Artur Shehun, Ferdinand Sulaj bëhet pronar i 1/18 të sipërfaqes totale, pasi i kishte premtuar Artur Shehut se do i jepte 1/6 e pjesës së tij për shpenzimet që do bënte Pullumb Petritaj lidhur

me procesin e kthimit dhe regjistrimit të pronës. Lidhur me veprimet e shitjes së kësaj prone, Ferdinand Sulaj u shpreh se është marrë djali i tij Soni dhe se ai mund të ketë informacion. Te njëjtën mënyrë veprimi sa i përket kthimit dhe regjistrimit të pronësisë deklaroi se është kryer dhe për pronën e ndodhur në Akërm, të cilën gjithashtu ia ka shitur shoqërisë "Albania Land Development".

Në datën 29.05.2026, është bërë marrja në pyetje e shtetasit Soni Sulaj, i biri i Ferdinand Sulaj, i cili u shpreh se rreth 3-4 vite më parë, babai i tij kishte firmosur një prokurë ku autorizonte Çobon, përfaqësuesin e Artur Shehut, që pronat në Akërm dhe Zvërnec të jepeshin për ndërtim me përqindje 18%. Sipas dijenisë së tij, shoqëria që do të kryente ndërtimin kishte përfaqësues Redi Strugën dhe mbante emrin "South Development", megjithëse nuk e mbante mend të plotë. Lidhur me këtë marrëveshje, ai ishte i sigurt se kishte dalë leja e zhvillimit, por nuk dinte të thoshte nëse kishte dalë edhe leja e ndërtimit. Marrëveshja nuk u zbatua dhe sipas tij investitori ishte pala që u tërhoq. Gjatë kësaj kohe, Soni Sulaj deklaroi se kishte diskutuar me një avokat të quajtur Enkes, banues në lagjen e tij në Vlorë, i cili kishte mbajtur komunikim me persona të tjerë që ai nuk i njohte. Me Enkesin kishte pasur komunikim deri në momentin kur u prish marrëveshja e parë (pa u shkëputur kontrata), por pala investitore kishte shprehur interes për blerje. Meqënëse nuk ra dakord për çmimin e shitjes, ai ndërpreu marrëdhëniet me Enkesin për një periudhë të caktuar.

Rreth fundit të vitit 2025, deklaruesi u shpreh se ka komunikuar me një avokate të quajtur Sara Banushi. Me Sarën kishte biseduar për përmbajtjen e kontratave të shitjes së dy pronave me sipërfaqe 94,500 m² dhe 60,500 m² në Akërm dhe Zvërnec, si dhe për blerjen e dy apartamenteve (120 m² dhe 160 m²), një dyqani (80 m²) dhe 3-4 garazhe. Për këto prona ishte rënë dakord që ai t'i blinte me vlerë rreth 2 milion euro, shumë që do të paguhej pas kalimit të pagesës së shitjes së pronave në Akërm dhe Zvërnec. Gjithashtu, nga Kastrati ka blerë një makinë S Class me targa AB220XJ, në vlerën 220,000 euro, e cila do të likuidohet pas kalimit të parave nga shitja e pronave. Pas dakordësimit për shitjen e pronave, Sara ka lajmëruar vazhdimisht për kontratat dhe datat e nënshkrimit. Soni Sulaj deklaroi se nuk e mban mend kush e kishte lidhur me Sarën, mund të kishte qenë Enkesi ose ajo e që e ka kontaktuar. Kishte komunikuar edhe me një

Faqe 5

person të quajtur Ridgers, që kishte lidhje me Kastratin. Soni Sulaj kishte kërkuar të takonte Musa Kastratin për ta falënderuar. Takimi ishte lënë për javën pasuese, por me shkëputjen e komunikimit nga pala tjetër, ai nuk besonte se do të zhvillohej.

I pyetur në lidhje me raportin e tij me shtetasin Artur Shehu, ai deklaroi se e ka takuar Arturin dy herë, njëherë në Nicë të Francës dhe herën e dytë në Majorka të Spanjës. Të dyja takimet, sipas deklaruesit janë zhvilluar me qëllim rënien dakord për pronat.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës, prokurorët argumentojnë se: Bazuar në sa më sipër, nisur nga fakti se shtetasit Pullumb Petritaj dhe Leonard Bishaj kanë qenë përfaqësuesit e shtetasit Artur Shehu ndër vite dhe kanë kryer të gjitha veprimet për kthimin e pronave dhe regjistrimin e tyre, vlerësohet me interes kontrolli i vendeve dhe kontrolli personal i tyre pasi mund të kenë dokumenta lidhur më regjistrimin e pronave objekt i këtij hetimi.

Nga analiza e veprimeve noteriale, janë konstatuar shumë akte noteriale mes Artur Shehut dhe fëmijëve të Pullumb Petritaj dhe kontretisht: Kontratë Shitje Pasurie të Paluajtshme Nr 443 Rep., Nr. 240 Kol., datë 28/05/2014, me Palë Shitëse: Ramiz Shehu, Merjeme Shehu, Sadihane Shehu, Lulëzim Shehu, Lavdosh Shehu dhe Seit Shehu - të gjithë të përfaqësuar nga Pullumb Petritaj dhe Palë Blerëse: Ina Petritaj (H403231521), me objekt kontrate: Pasuria me numër 263, Z.K. 1007, Vol. 5, faqe 189, me sipërfaqe 1.000.000 m², me çmim shitje 253.000.000 Lekë, para të cilat është deklaruar se janë paguar jashtë zyrës noteriale.

Shtetasi Enkes Hysendhima, ashtu siç u evidentua më sipër, ka marrë pjesë aktivisht në koordinimin e personave të ndryshëm lidhur me shitjen e pronave të shtetasve Ferdinand Sulaj dhe Artur Shehu, edhe pse ai nuk rezulton të jetë përfaqësues i ndonjëres nga palët.

Më datë 21.11.2025, është nënshkruar kontrata e premtim shitjes me nr. 4958 rep., nr. 2633 kol., me palë premtuese shitëse shtetasin Artur Shehu të përfaqësuar nga Leonard Bishaj dhe me palë premtuese blerëse, shoqërinë "Albania Land Development" sh.p.k. me Nipt M567272081, të përfaqësuar nga administratori, shtetasi Redi Struga. Pala premtuese shitëse premtonte të shesë, ndërsa pala premtuese blerëse premtonte të blejë, pjesën ideale 17/18 (shtatëmbëdhjetë të tetëmbëdhjetën) që i korrespondon sipërfaqes prej 1,028,641.67 m³, nga pasuria e paluajtshme me numër 1/1, me sipërfaqe totale prej 1,089,150 m³, e ndodhur në Zvërnec, Vlorë, regjistruar në Z.K. 3951. Çmimi i përcaktuar është në shumën 5,500,000 Euro. Këtë pronë, Artur Shehu e ka fituar nga kontrata e shkëmbimit me nr. 3259 rep. dhe nr. 1945 kol., 11.11.2011.

Me procesverbalin e datës 28.05.2026 për këqyrjen dhe marrjen e dokumentacionit pranë zyrës së noteres Amela Mukaj, është marrë një kopje e njehsuar me origjinalin e kopje e kontratës me nr 2062 rep., dhe nr. 1166 kol., e datës 24.04.2026. Pasuria me nr. 1/1, në sipërfaqen 1,028,641.67 m² i shitet shoqërisë "Albania Land Development" në vlerën 122.000.000 (njëqind e njëzetë e dy milion) euro.

Më datë 21.11.2025, është nënshkruar kontratë premtim shitje pasuri e paluajtshme nr. 4957 rep., nr. 2632 kol., me palë shitëse shtetasit Ferdinant Sulaj, Burbuqe Sulaj dhe me palë blerëse "Albania Land Development" sh.p.k. Shuma: 150,000 Euro.

Më datë 21.11.2025, është nënshkruar kontratë premtia shitje pasuri e paluajtshme nr. 4956 rep., nr. 2631 kol., me palë shitëse shteta Ferdinant Sulaj, Burbuqe Sulaj ne me palë blerëse "Albania Land Development" sh.p.k. Stama: 150,000 Euro.

Faqa 6

Me procesverbalin e datës 28.05.2026 për këqyrjen dhe marrjen e dokumentacionit pranë zyrës së noteres Amela Mukaj, është marrë një kopje e njehsuar me origjinalin e kopje e kontratës me nr. 2060 rep. dhe nr. 1164 kol., e datës 24.04.2026, ku pala shitëse Ferdinant Sulaj dhe Burbuqe Sulaj i shet shoqërisë "Albania Land Development" pasurinë me nr. 1/1, Z.K. 3951, me sipërfaqe 60508.3 m², në vlerën 10.562.500 euro.

Gjithashtu, është marrë dhe kontrata e datës 24.04.2026, Ferdinant Hamza Sulaj dhe Burbuqe Sali Sulaj i shesin "Albania Land Development" një pasuri të paluajtshme në vlerën 8,648,500 euro.

Lidhur me shoqërinë "Albania Land Development" janë kryer verifikime në sistemin notarial dhe ka rezultuar se kjo shoqëri ka kryer dhe veprimet noteriale si vijon: Më datë 27.11.2025, është nënshkruar kontratë premtim shitje nr. 5064 rep., nr. 2689 kol., me

blerëse shoqërinë "Albania Land Development" sh.p.k. dhe me palë shitëse shtetasen palë Feriare Ndreu e dtl. 26.09.1996. Objekt i kontratës është pasuria e paluajtshme e llojit "pyll", me sipërfaqe prej 78,000 m², të ndodhur në Akërnj, Vlorë, me nr. pasurie 262/5/2, 7.K. 1007. Çmimi i shitjes është caktuar në shumën 2,000,000 Euro, që do të paguhet brenda muajit të parë nga data e lidhjes së kësaj kontrate. Këtë pasuri, pala premtuese shitëse e ka fituar me anë të kontratës së shkëmbimit nr. 2145 rep., nr. 773 kol., datë 04.11.2021. Nga verifikimi i kryer në sistemin online noterial NISA, në aktin noterial të kontratës së shkëmbimit nr. 2145 rep., nr. 773 kol., datë 04.11.2021, shfaqen si palë shkëmbyese 1 shtetasit Raimond Jakup Mëzit dhe Burbuqe Barjam Mëzi, dhe si palë shkëmbyese 2 shtetasja Feriare Petritaj. Në kartelën e kësaj pasurie është regjistruar kërkesë padia nga kërkuesi "INQ Project", i cili në cilësinë e palës paditëse, kërkon detyrimin e palës së paditur Feriare Petritaj, të përmbushë detyrimin kontraktor, sipas kushteve që rrjedhin nga kontrata e premtim shitjes nr. 280/117, datë 10.02.2022.

Më datë 09.12.2025, është nënshkruar kontrata të tjera (premtim shitje) nr. 5210 rep. nr. 2784 kol., me palë "South Adriatic Development" sh.p.k. me Nipt M12215020U dhe me palë 1 "Albania Land Development" sh.p.k. Shuma: 6,400,000 euro. Në datën 21.04.2026, me kontratën me nr. rep. 1964 dhe nr.kol. 1117, datës 21.04.2026, "South Adriatic Development" i

shet shoqërisë "Albania Land Development" një pasuri të paluajtshme në vlerën 70.289.222 euro, në vijim të kontratës premtim shitje me nr. 5210 rep. nr. 2784 kol., të datës 09.12.2025. Çmimi i shitjes është 70.289.000 euro (shtatëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) euro, i cili do të paguhet me këste. Kësti i parë prej 6.400.000 (gjashtë million e katërqind mijë) euro është paguar nga blerësi nëpërmjet pagesës sipas kontratës premtim shitje me nr. 5210 rep., nr. 2784 kol., të datës 09.12.2025. Kësti i dytë prej 2.699.630 është paguar nga blerësi sipas faturës së datës 16.04.2026, në favor të DRTT në lidhje me rivlerësimin e pasurisë nga shitësi. Ndërsa kësti i tretë do paguhet në bankë nëpërmjet llogarisë së noteres, brenda muajit maj 2026.

Bazuar në sa më sipër, nisur nga fakti se shtetasit Pullumb Petritaj dhe Leonard Bishaj kanë qenë përfaqësuesit e shtetasit Artur Shehu ndër vite, dhe kanë kryer të gjitha veprimet për kthimin e pronave dhe regjistrimin e tyre, vlerësohet me interes kontrolli i vendeve dhe kontrolli personal i tyre pasi mund të kenë dokumenta lidhur më regjistrimin e pronave objekt i këtij hetimi.

Nga analiza e veprimeve noteriale, janë konstatuar shumë akte noteriale mes Artur Shehut dhe fëmijëve të Pullumb Petritaj die konkretisht: Kontratë Shitje Pasurie 1 Paluajtshme Nr 443 Rep, Nr. 240 Kol., datë 28/05/2014, Ne Palë Shitëse: Ramiz Shehu, Merjeme Shehu, Sadihane Shehu,

Faqe 7

Lulëzim Shehu, Lavdosh Shehu dhe Seit Shehu të gjithë të përfaqësuar nga Pullumb Petritaj dhe Palë Blerëse: Ina Petritaj (1403231521), me objekt kontrate: Pasuria me numër 263, ZK 1007, Vol 5, faqe 189, me sipërfaqe 1.000.000 m², me çmim shitje 253.000.000 Lekë, para të cilat është deklaruar se janë paguar jashtë zyrës noteriale.

Shtetasi Enkes Hysendhima, ashtu siç u evidentua më sipër, ka marrë pjesë aktivisht në koordinimin e personave të ndryshëm lidhur me shitjen e pronave të shtetasve Ferdinand Sulaj dhe Artur Shehu, edhe pse ai nuk rezulton të jetë përfaqësues i ndonjëres nga palët. Vlerësohet me interes për t'u kontrolluar dhe zyra e avokatisë së shtetasit Enkes Hysendhima, pasi ky shtetas mund të ketë përdorur zyrën e tij për të takuar persona të ndryshëm lidhur me shitblerjen e pronave në Zvërnec dhe në Akërnë dhe se në zyrë mund të ketë dokumente që do t'i vlenin hetimeve. Për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 52, përpara se të ushtrohet kontroll në zyrën e tij, do të njoftohet Dhoma e Avokatisë.

Gjithashtu, edhe shtetasi Redi Struga ka përfutur, ka blerë dhe ka patur marrëdhënie bashkëpunimi për sipërfaqet e tokave me anë të shtetasit Artur Shehu dhe këto pasuri i ka shitur tek shoqëria "Albanian Land Development" sh.p.k.

Lidhur me shtetasin Redi Struga, nga analiza e veprimeve noteriale ka rezultuar se ai ka nënshkruar dhe më parë akte noteriale me shtetasin Artur Shehu dhe konkretisht ka blerë nga ky i fundit pasurinë e paluajtshme në vlerën 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) euro.

Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. 2016 rep., nr. 1204 kol. datë 20.11.2021 me palë shitës shtetasin Artur Shehu dhe blerës shoqërinë "South Adriatic Development" sh.p.k. me Nipt M12215020U. Shuma e transaksionit 2,400,000 euro (313,584,000 lekë). Akti nuk është i ngarkuar në regjistrin notarial dhe në sistemin Nisa.

Kontratë Sipërmarrje nr. 4194 rep., nr. 1683 kol., dt. 04.08.2022, notere Amela Mukaj, me palë sipërmarrëse shoqërinë "South Adriatic Development" sh.p.k. me Nipt M12215020U dhe palë pronare shtetasin Artur Shehu (përfaqësuar nga Leonard Bishaj). Duke qenë se Sipërmarrësi Shoqëria "South Adriatic Development" ka në pronësi Pasurinë me sipërfaqe 1,225,500 m² (një milion e dyqind e njëzet e pesëmijë e pesëqind metra katrorë), ndodhur në Akërnë, Vlorë me numër pasurie Nr. 262/12, vërtetuar me Çertifikatë Regjistrimi Pronësie pajisur me Kodin Unik të identifikimit 1007005221, ndodhur në adresën Akërnë, Zonën Kadastrale Nr. 1007; Pronari i Tokës ka në pronësi në masën 17/18 pasurinë me sipërfaqe 1,089,150 (një milion e tetëdhjetë e nëntëmijë e njëqind e pesëdhjetë) m², ndodhur në adresën Zvërnec- Vlorë, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë (ASHK), me nr. 1/1, Zona Kadastrale 3951.

Meqënëse pronat e mësipërme janë kufitare dhe në vazhdimësi të njëra-tjetrës në vijën bregdetare, ato shërbejnë si prona ndihmëse duke i rritur kështu vlerën tregtare në funksion të zhvillimit. Ndaj me qëllim interesin e përbashkët për një zhvillim sa më optimal të të dyja pasurive, palët lidhin kontratën e mëposhtme. Rezulton vetëm faqja e parë e kontratës. Në fund të vitit 2025 shoqëria "South Adriatic Development" sh.p.k sipërfaqja i është shitur shoqërisë "Albania Land Development" sh.p.k. Këto veprime të kryera në vite ndërmjet shtetasve Artur Shehu dhe Redi Struga tregojnë për lidhje dhe interesa të përbashkëta të tyre, veprime të planifikuara dhe koormuara në kohë dhe kontrolli i tij është i domosdoshëm për të gjetur dokumenta apo të dhëna të garë që i shërbejnë këtij hetimi.

Faqe 8

Për këtë arsye paraqitet e nevojshme lejimi i kontrollit personal, të zyrave apo banesave të personave të lartpërmendur. Kjo me qëllim për të konstatuar sende që lidhen me këtë vepër penale të "Pastrimit të Produkteve të veprës penale" kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 287 e 333/a të Kodit Penal:

- a) dokumenta të ndryshëm që mund të përmbajnë të dhëna mbi pronësi të pasurive të luajtshme të paluajtshme, dokumente bankar, librezë llogarish e kursimi, fatura transaksionesh dhe transfertash parash; si shënime mbi të drejta pasurore, të drejta përfaqësimi e sende të tjera të kësaj natyre;
- b) vlera monetare që lidhen me përfitim nga kjo vepër, si dhe çdo send tjetër që lidhet me këtë vepër penale;

c) Pajisje kompjuterike, si kompjuter laptop; aparate telefoni që iu përkasin shtetasve për të cilët kërkohet kontrolli apo personave të tjerë që gjenden të pranishëm, kjo me qëllim sekuestrimin e të dhënave kompjuterike e kqyrjen dhe marrjen e të dhënave që ato përmbajnë në lidhje me faktet e mësipërme, mënyrës së përfitimit të pasurive të paluajtshme, personave me të cilët kanë kontaktuar për këto pasuri dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me faktet e sipërcituara.

Sa më sipër rezulton të jenë përmbushur kushtet për identifikim dhe lokalizim vendndodhja e banesave, zyrave, të personave (sipas informacionit të paraqitur), si dhe është përcaktuar edhe objekti i kontrollit si kushte të rëndësishme për të ushtruar një kontroll sipas neneve 202, 202/a të Kodit të Procedurës Penale, rrethana këto që e bëjnë të domosdoshme kërkimin që ky veprim të lejohet nga ana e gjykatës.

Për shkak të urgjencës kërkohet lejimin e kontrollit të banesës edhe përtej orarit të parashkuar në Kodin e Procedurës Penale nisur nga fakti se jemi në kryerje e sipër të veprimeve hetimore.

Sa më sipër, mbështetur në nenet 202, 202/a, 208/a e 205 të Kodit të Procedurës Penale, prokurorët e çështjes kërkojnë:

1. Të lejohet kontrolli i vendeve dhe i personave, përcaktuar si më poshtë:

1) Banesa e shtetasit Leonard Bishaj, i biri i Ferik dhe i Dritë, lindur më 24.03.1969 në Vlorë me nr. personal G90324083R, e ndodhur në rrugën Murat Tërbaçi, nd. 73, h. 3, ap.19, Vlorë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektisht banimin

1.1 Kontrolli personal i shtetasit Leonard Bishaj, i biri i Ferik dhe i Dritë, lindur më 24.03.1969, në Vlorë me nr. personal G90324083R.

2) Ambient zyrë e shoqërisë "Adhenis" sh.p.k., me Nipt M06628201S, e ndodhur në Vlorë, Lagjja Uji i Ftohtë, Rruga Aleksandër Moisiu, Objekti ish-Kompleksi Kristal, pranë Tunelit Vlorë, Ndërtesë private një katëshe.

3) Banesa e shtetasit Pullumb Petritaj, i biri i Nexhmedin dhe i Perjana, lindur më 01.10.1964, në Vlorë me nr. personal G41001096N, e ndodhur në rrugën Ali Mesapliku, nd. 12, h. 3, ap. 1, Vlorë, apo të i adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektisht banimin

3.1 Kontrolli personal i shtetasit Palumb Petritaj, i biri i Nexlunedin dhe i Perjana, lindur më 01.10.1964, në Vierk nie it personal G41001096N;

Faqe 9

1.2 Kontrolli personal i shtetasit Armalindo Petritaj, i biri i Pullumb dhe i Majlinda, lindur më 24.12.1987, me nr. personal 171224064K.

4) Banesa e marrë me qera nga shtetasi Armalindo Petritaj, e ndodhur në kompleksin Ambasador 3, Tiranë.

5) Banesa e shtetasit Enkes Hysendhima, i biri i Hysni dhe i Mbaresë, lindur më 21.01.1981, në Vlorë me nr. personal 110121034), e ndodhur në rrugën Meno Gjoleka, nd. 12, h. 3, ap. 1, Orikum, Vlorë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin

5.1 Kontrolli personal i shtetasit Enkes Hysendhima, i biri i Hysni dhe i Mbaresë, lindur më 21.01.1981, në Orikum, Vlorë me nr. personal 110121034J

6) Zyra e shtetasit Enkes Hysendhima (zyrë avokatie) e ndodhur në Lagjen Hajro Cakerri, Rr. Sulejman Delvina, Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Kt.II

7) Banesa e shtetasës Feriare Ndreu, e bija e Pullumb dhe e Majlinda, lindur më 26.09.1996, në Vlorë me nr. personal J65926078T, e ndodhur në rrugën Kosova, nd. 18, h. 2, Lezhë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasja ushtron efektivisht banimin.

7.1 Kontrolli personal i shtetasës Feriare Ndreu, e bija e Pullumb dhe e Majlinda, lindur më 26.09.1996, në Vlorë me nr. personal J65926078T.

8) Banesa e shtetasës Ina Shuraja, e bija e Pullumb dhe e Majlinda, lindur më 08.10.1993, në Vlorë me nr. personal J36008095G, e ndodhur në rrugën Brigada VIII, nd. 130, h.3, ap. 27, NJA nr.5, Tiranë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasja ushtron efektivisht banimin.

8.1 Kontrolli personal i shtetasës Ina Shuraja, e bija e Pullumb dhe e Majlinda, lindur më 08.10.1993, në Vlorë me nr. personal J36008095G.

9) Banesë e shtetasit Redi Struga, i biri i Bujar dhe i Mirlinda, lindur më 22.09.1982, në Tiranë, me nr. Personal 1209221210, e ndodhur në Rruga Bardhyl, nd. 22, h.1, NJA 3, Tiranë apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin;

9.1 Kontrolli personal i shtetasit Redi Struga, i biri i Bujar dhe i Mirlinda, lindur më 22.09.1982, në Tiranë, me nr. Personal 1209221210.

10) Ambient zyrë e shoqërisë "South Adriatic Development", me Nipt M12215020U, e ndodhur në Tiranë, Njësia bashkiake nr. 8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, përballë Qendrës Lincoln.

2. Ky kontroll të kryhet mënjeherë nga oficerët e Byrosë Kombëtare 18 Hetimit, mbështetur nga Oficerë të Drejtorisë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 72 orëve nga momenti i datës që mban veni i gjykatës.

Faqe 10

111.Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 37 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: "1 Paprekshmëria jediseve që njësohen me të, mund të banesës është e garantuar. 2. Kontrollat e banesës, si dhe të mjediseve me ligj.3. Askujt nuk mund t'i bëhet behen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik".

Neni 8 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut parashikon se: "Ç'do person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe letërkëmbimi i tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, veçse në shkallën e

parashikuara nga ligj... Neni 52 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Këqyrjet dhe kontrollimet në zyrën e mbrojtësit lejohen vetëm:

a) kur ai ose persona të tjerë që zhvillojnë vazhdimisht veprimtari në të njëjtën zyrë janë të pandehur dhe vetëm brenda qëllimeve për të provuar veprën penale që u atribuohet:

b) për të zbuluar gjurmët ose provat materiale të veprës penale ose për të kërkuar sende a persona të përcaktuar në mënyrë të posaçme.

c) në rastet kur mbrojtësi ndodhet në kushtet e flagrancës ose ndjekjes, sipas paragrafit 1, të nenit 298, të këtij Kodi.

2. Para se të bëjë këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin në zyrën e një mbrojtësi, organi procedues njofton këshillin drejtues të dhomës së avokatëve me qëllim që një anëtar i tij të ketë mundësinë që të jetë i pranishëm në veprimet. Përveç rasteve të flagrancës, organi procedues shtyn këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin deri në mbërritjen e anëtarit të caktuar, por jo më shumë se 2 orë pasi është informuar Dhoma e Avokatisë. Në çdo rast një kopje e aktit i dërgohet këshillit drejtues të dhomës së avokatëve.

3. Këqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet në zyrat e mbrojtësve, sipas shkronjave "a" dhe "b", të paragrafit 1, të këtij neni, i bën gjyqtari personalisht, kurse gjatë hetimeve paraprake ato i bën prokurori në bazë të një vendimi autorizues të gjykatës.

4. Nuk lejohet përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë.

5. Ndalohet çdo formë kontrolli e korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

6. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren".

Neni 202 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale gjykata

merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës.

2. Gjykata që ka nxjerrë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit.

3. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në namin 298".

Neni 202/a i K.Pr. Penale parashit "1. Vendimi për lejimin e kontrollit duhet të tregojë llojin e kontrollit, personin që kontroll het dhe gjenealogjet e tij, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat materiale apo sendet që kërkohen, arsyet që lejojnë kontrollin, si dhe autoritetin që do të kryejë atë.

2. Kur ka arsye të bazuara se të dhënat, informacionet, programet informatike ose gjurmë të tyre, gjenden në një sistem informatik ose telentetik, edhe kur ky është nahrojtur me masa sigurie,

faqe 11

gjykata merr vendim për kontrollin, duke urdhëruar masa teknike të përshtatshme, të cilat sigëvojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë ndryshimin e tyre. Vendimi i kontrollit shihet të përcaktojë llojin e informacionit që kërkohet dhe mënyrën e marrjes së tij.

Gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga kërkesa e prokurorit kundër vendimit që refuzon kërkesën për kontroll mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga

marrja e akteve. 4. Kontrolli duhet të përfundojë brenda 72 orëve nga momenti i marrjes së vendimit për kryerjen

Neni 204 i K.Pr. Penale parashikon se: "1. Para se të bëhet kontrolli i personit, atij që do të kontrollohet i dorëzohet një kopje e vendimit të kontrollit, duke i bërë të ditur të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, me kusht që ai të gjendet shpejt dhe të jetë i përshtatshëm.

2. Kontrolli bëhet duke respektuar dinjitetin dhe integritetin personal të atij që kontrollohet. Kontrolli i personit bëhet nga një person i së njëjtës gjini, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është e mundur për shkak të rrethanave".

Neni 205 i K.Pr. Penale parashikon se: "1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke e njohur me të drejtën për të

kërkuar praninë e një personi të besuar, i cili ndodhet aty dhe është i përshtatshëm, sipas nenit 108, të këtij Kodi, ose mbrojtësit të tij.

2. Kur i pandehuri kërkon praninë e mbrojtësit gjatë kryerjes së kontrollit, organi procedues shtyn kryerjen e kontrollit deri në mbërritjen e mbrojtësit, por jo më shumë se 2 orë nga momenti që mbrojtësi ka marrë dijeni për kontrollin. Gjatë kësaj kohe, organi procedues mund të kufizojë lëvizjen e personit të interesuar dhe personave të tjerë që ndodhen në vendin që do të kontrollohet.

3. Shtyrja e kontrollit, sipas paragrafit 2, të këtij neni, zgjat afatin përkatës të parashikuar në paragrafin 4, të nenit 202/a, të këtij Kodi.

4. Organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin proven materiale ose sendet që i përkasin veprës penale. Ai mund të urdhërojë që të pranishmit të mos largohen para se të mbarojë kontrolli dhe të kthehen forcërisht ata që largohen.

5. Kur nuk njihet ose nuk gjendet pronari ose poseduesi i sendit, organi procedues kryen kontrollin në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të caktuar kryesisht".

Neni 206 i K.Pr.Penale parashikon se: "1. Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme organi procedues mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve".

Neni 208/a të K.Pr.Penale parashikon se: "1. Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, gjykata, me kërkesën e prokurorit, urdhëron sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhenat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik

2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkua kompjuterike janë memorizuar në një sistete tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kane prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuteri

3. Në zbatim të vendimit gjykatës, prokurorin ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa:

a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të sigurar sistemin kompjuterik,

vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhenash; për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike:

kompjuterike me të drejtë hyrjeje: c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet

për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.

njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e

4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka të dhëna kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme".

Neni 2091 K.Pr.Penale parashikon se: "1. Kur gjykata ka arsye të bazuara të mendojë se në zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlerë, zarfe, pako, telegrame dhe objekte të tjera të korrespondencës që janë dërguar nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nepermjet një personi tjetër, vendos sekuestrimin e tyre.....

IV. Vlerësimi i Gjykatës

Në lidhje me rrethanat e faktit të shpjeguara si më sipër, si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të sipërcituara, Gjykata çmon të pranojë kërkesën e organit të akuzës për lejin e kontrollit të personave, vendeve (banesa dhe zyra), në kuadër të procedimit penal në fjalë.

Në Kodin e Procedurës Penale janë përkufizuar "mjetet e kërkimit të provës" dhe llojet e provave. Dallimi i mjeteve të kërkimit të provës me llojet (mjetet) e provës, qëndron në faktin se, këto të fundit karakterizohen nga aftësia për t'i ofruar gjykatës rezultate provash, të cilat janë drejtpërsëdrejti të përdorshme gjatë procesit të vendimmarrjes së gjykatës. Aftësia (fuqia) provuese e llojeve të provës, krijohet në momentin e formimit dhe të përfutimit të llojit të provës. Procesverbali i kontrollit të vendeve nuk përbën mjet (lloj) prove, por mjet për kërkimin e provës, në rastin konkret atë të provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale.

Me mjetin e kontrollit do të kuptohet veprimtaria e kërkimit të imtësishëm dhe të kujdesshëm të personave, sendeve, vendeve, siç mund të jenë banesa, apo vendet e tjera. Pra, kontrolli është një ndërhyrje fizike mbi një person të caktuar apo në një vend të mbrojtur nga pikëpamja kushtetuese, pra një vend ku personi gëzon pritshmëri privatësie dhe liri nga ndërhyrjet e autoriteteve publike.

Qëllimi i kontrollit nuk është përshkrimi i detajuar i asaj çka vëzhgohet, sikundër është këqyrja, por kërkimi i një sendi, pra i objektit të kontrollit duke synuar në arritjen dhe sekuestrimin e atyre sendeve që përbëjnë prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës

penale. Mund të ndodhë që kontrolli të bëhet edhe me qëllim kryerjen e një ndalimi, ekzekutimi të një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim.

Nga analiza e nenit 202 Kodit të Procedurës Penale, vërehet se në raste normale, dispozita parashikon si autoritete disponimin e kontrollit, gjykatën. Në këtë mënyrë garantohet paprekshmëria e banesë parashikuar shprehimisht nga neni 37: Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në bazë të cilës, përcaktohet e "kontrollat e hasues, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj. Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjamir nje mezik që i kanoset sigurimit

Faqe 13

pëNid." Kusht themelor për të proceduar me disponimin e kontrollit përbën prania e elementit "arsyeve të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij, në një vend tjetër, apo normale, dispozita në fjalë parashikon se organi që disponon mbi kërkesën për gjykim është ne banese, prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale". Në raste gjykata, e cilat nxjerr vendimin të arsyetuar dhe që mund të veprojnë vetë ose të urdhërojnë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit. Ndërsa në fazën e hetimeve paraprake, në raste flagrante ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298 të Kodit të gjenden të fshehura sende ose gjurmë të "veprës penale" që mund të zhduken a të humbasin ose Procedurës Penale, d.m.th. kur ekzistojnë arsye të bazuara për të menduar se mbi personin që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur, apo kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 të nenit 298 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Në këto raste, procesverbali i veprimeve të kontrollit i dërgohet pa vonesë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve vijuese vleftëson kontrollimin me vendim të arsyetuar. Qoftë në rastin kur kontrolli disponohet nga gjykata, qoftë në rastin kur kontrolli disponohet në raste urgjente nga ana e policisë gjyqësore, vendimi përkatës i gjykatës dhe vendimi vleftësues i prokurorit përbën një garanci, e cila përcakton personin që do të përcaktimin e objektit dhe qëllimit të kontrollit dhe eventualisht të sekuestrimit. kontrollohet, kushtet ligjore dhe faktike që përligjin një masë të tillë kufizuese, si edhe

të Sa i përket qëllimeve të caktuara që kërkohen të ndiqen me anë të vendimit për sekuestrimin e sendit, në bazë të nevojave procedurale, ligji procedural penal parashikon tre kategori sekuestrimesh. a) sekuestrimet për qëllime prove, i cili ka të bëjë me qëllimin e vërtetimit

fakteve të procedimit dhe përbën një mjet për kërkimin e provës, sipas nenit 208 -220 të K.Pr.Penale; pra është sekuestrimi me qëllim mbledhjen e provave materiale, i cili nuk përbën një masë sigurimi pasuror, prandaj është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave elementi që dallon këtë institut, nga llojet e tjera të sekuestrimit; b) sekuestroja konservative Neni 270-273 të Kodit të Procedurës Penale, si masë sigurimi pasuror; c) sekuestro preventive, masë sigurimi pasuror Neni 274-276 të Kodit të Procedurës Penale. Nëse ka arsye për të besuar se një person i caktuar mund të ketë kryer një vepër penale dhe se krijohet një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, si edhe në kushtet e arrestit në flagrancë apo të ndalimit të të dyshuarit për një krim, atëherë është e arsyeshme që personit të dyshuar t'i kërkohet ndërhyrja për kontrollin e tij vetjak apo ajo e banesës në të cilën personi i dyshuar mendohet se banon.

Sa sipër, rezulton që Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal dhe po kryen hetime paraprake për veprat penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar minal" dhe "Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 287, 333/a dhe 394/1 të Kodit Penal.

Nga hetimet që po zhvillon në mënyrë dinamikë së lidhje me disa veprime dhe transaksione të kryera përgjatë fundit të vitit 2025 e në vitin 2026 janë konstatuar veprime në lidhje me tjetërsimin e disa pasurive të paluajtshme, sipëriage toke, të ndodhura në zonat Akërni/Zvërnec,

faqe 14

kohë, ndërmjet disa personave, banorë të zonës, të cilët pretendojnë përfitimin të këtyre Vlorë. Në lidhje me këto pasuri konstatohet se ka konflikte të hershme dhe të vazhdueshme në Agjensinë e Kadastrës, në emër fillimisht të trashëgimtarëve të shtetasit Artur Shehu, dhe më pas sipërfaqeve me anë AMTP-ve, ndërkohë që sipërfaqet e tokës rezultojnë të regjistruar në emër të këtij të fundit (i cili rezulton ndër të tjerë t'i ketë blerë ato nga trashëgimtarët) dhe në emër të shtetasit Ferdinand Sulaj, trashëgimtar i shtetasit Seit Shehu. Një pjesë e këtyre pronave janë tjetërsuar tek shtetasi Pullumb Petritaj, i Shehu në proceset gjyqësore dhe administrative për regjistrimin e pasurive. i cili rezulton të ketë qenë përfaqësues i shtetasit Seit

Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezultojnë se, konfliktet janë akoma në procese gjyqësore duke mos patur vendimmarrje të formës së prerë, ku edhe për pasurinë me nr. 262, zona kadastrale 1007 vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka shërbyer për regjistrimin e pasurive është prishur nga Gjykata e Lartë. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve gjyqësore citohen edhe dokumenta të përdorur përgjatë proceseve të cilat kanë rezultuar të falsifikuara. Gjithashtu, në dosje gjyqësore dhe çështje të tjera, ku shtetasi Pullumb Petritaj është dënuar dhe ka patur krijimin e dyshimeve në lidhje me mënyrën e marrjes së këtyre pronave, mbahen parasysh edhe procese të shumta të shumta gjyqësore në lidhje me falsifikim të dokumentave për prona që lidhen me shtetasin Artur Shehu, me të njëjtën mënyrë të vepruari. Gjithashtu, ai

është në proces gjyqësor dhe për përdorim të dokumenti të falsifikuar në lidhje me këto prona, referuar vendimit me nr. 151, datë 27.06.2024 të Gjykatës së Lartë.

Ndodhur para këtyre rrethanave, marrë parasysh mënyrën e të vepruarit nga personat në regjistrimin e pronave (ku rezultojnë aplikime dhe veprime të shpejta në regjistrimin e pronave) si dhe pas regjistrimit duke patur një sërë veprimesh shitjesh, shkëmbimesh, me përfitues shtetasit Artur Shehu, ku në emër dhe për llogari të tij vepron shtetasi Leonard Bishaj, Pullumb Petritaj e Enkes Hysendhima, veprim të cilat janë të planifikuara dhe të koordinuara me pjesëmarrje aktive të personave të tjerë (referoju deklarimeve të dhëna nga shtetasit Soni Sulaj dhe Amela Mukaj), të cilët kanë ndërmjetësuar dhe kanë ndjekur këto veprime me pjesëmarrje dhe marrëdhënie juridike të interes të shtuar, pa patur të paktën deri tani një interes që rrjedh nga caktuara, krijohen dyshime të arsyeshme për kryerje të veprave penale "Pastrim i produkteve të veprës penale" kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 287 c 28/4, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal.

Nga ana e organit të akuzës, dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, janë evidentuar një sërë veprimesh juridike, kontrata të lidhura në kohë të ndryshme, mbi pronat e paluajtshme të ndodhura në zonat Akürni/Zvërnec, Vlorë dhe po ashtu janë identifikuar personat dhe shoqëritë që kanë kryer veprime të ndryshme dhe në cilësi të ndryshme, lidhur me këto prona, si dhe tjetërsimin e tyre.

Bazuar në sa më sipër sisur nga fakti se shtetasit Pullumb Petritaj dhe Leonard Bishaj kanë qenë përfaqësuesit e shtersit Artur Shehu ndër vite, dhe kanë kryer të gjitha veprimet për kthimin e pronave dhe regjistrimin e tyre, gjendet e bazuar vërkesa e prokurorisë dhe lejohet kontrolli i vendeve, banesave të tyre apo i çdo ambienti tjetë ku ata efektivisht banojnë dhe kontrolli personal i tyre. Po ashtu, lejohet kontrolli, ambient zyre e shoqërisë "Adhenis" sh.p.k., pasi mund të kenë dokumenta lidhur më regjistrin e pronave chjekt i këtij hetimi. Nga analiza e veprimeve noteriale, janë konstatuar shumë akte noteriale mes Artur Shehut dhe fëmijëve të

Faqe 15

Pullumb Petritaj, që janë shtetasit: Armalindo Petritaj, Feriare Ndreu (Petritaj) dhe Ina Shuraja (Petritaj) Kështu, që gjendet e bazuar kërkesa e prokurorëve për kontrollin personal të këtyre shtetasve dhe të banesave të tyre ku jetojnë, apol ku jetojnë, apo ku ushtrojnë efektivisht banimin, si dhe banesa e marrë me qera nga shtetasit Armalindo Petritaj, Po ashtu, shtetasi Enkes Hysendhima, siç edhe rezulton dhe është analizuar nga ana e organit të akuzës, ka marrë pjesë aktivisht në koordinimin e personave të ndryshëm lidhur me shitjen e pronave të shtetasve Ferdinand Sulaj dhe Artur Shehu, edhe pse ai nuk rezulton të jetë përfaqësues i ndonjëres nga palet. Duke qenë se organi i akuzës vlerëson me interes për t'u kontrolluar dhe zyra e avokatisë së shtetasit Enkes Hysendhima, krahas kontrollit të tij personal dhe të banesës

së tij, pasi ky shtetas mund të ketë përdorur zyrën e tij për të takuar persona të ndryshëm lidhur me shit-blerjen e pronave në Zvërnec dhe në Akërnë dhe se në zyrë mund të ketë dokumente që do t'i vlenin hetimeve, atëherë gjykata lejon kontrollin personal të këtij shtetasi, të banesës së tij dhe të zyrës së tij të avokatisë. Kontrolli i zyrës së avokatisë, në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja "b" të K.Pr. Penale, lejohet me qëllim zbulimin e gjurmëve, apo të provave materiale të veprës penale, ose për të kërkuar sende a persona, që lidhen me faktet penale objekt akuze. Në referim të nenit 52, pika 2 të K.Pr. Penale, organi procedues para se të ushtrojë kontroll në zyrën e z. Hysendhima, për të cilën po e lejon gjykata, duhet të njoftojë Dhomën e Avokatisë (këshillin drejtues të dhomës së avokatëve).

Gjithashtu për sa rezulton nga aktet, edhe shtetasi Redi Struga ka përfituar, ka blerë dhe ka patur marrëdhënie bashkëpunimi për sipërfaqet e tokave me anë të shtetasit Artur Shehu dhe këto pasuri i ka shitur tek shoqëria "Albanian Land Development" sh.p.k., me administrator z. Struga. Të gjitha veprimet e kryera të rezultuara në vite ndërmjet shtetasve Artur Shehu dhe Redi Struga tregojnë për lidhje dhe interesa të përbashkëta të tyre, veprime të planifikuara dhe koordinuara në kohë dhe kontrolli i tij është i domosdoshëm për të gjetur dokumenta apo të dhëna të tjerë që i shërbejnë këtij hetimi. Për këtë arsye, gjykata autorizon/lejon kontrollin personal dhe të banesës së shtetasit Redi Struga dhe po ashtu edhe të ambienteve të zyrës së shoqërisë "South Adriatic Development".

Për sa sipër, paraqitet e nevojshme lejimi i kontrollit personal, të zyrave apo banesave të personave/shoqërive të lartpërmendur, duke qenë se janë individualizuar qartë personat që kërkohet të kontrollohen, si dhe objektet, vende dhe zyra. Kjo me qëllim për të konstatuar sende që lidhen me këtë vepër penale të "Pastrimit të Produkteve të veprës penale" kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 287 e 333/a të Kodit Penal dhe më konkretisht me qëllim gjetjen, fiksimit dhe sekuestrimin e sendeve, si më poshtë vijon:

. dokumenta dryshëm që mund të përmbajnë të dhëna mbi pronësi të pasurive të luajtshme paluajtshme, dokumente bankar, librezë llogarish e kursimi, fatura transaksionesh the transfertash parash; si shënime mbi të drejta pasurore, të drejta

.

përfaqësimi ende të tjera të kësaj natyre:

vlera monetare në lidhen me përftimin nga kjo vepër, si dhe çdo send tjetër që lidhet me këtë vepër penain

Pajisje kompjuterike, si kompjuter laptop: Aparatë teletonta përkasin shtetasve për të cilët kërkohet kontrolli apo personave të verë që gjenden pranishëm, kjo me qëllim sekuestrimin e të dhënave kompjuterike kqyrjen dhe marrjen e të dhënave që ato përmbajnë në lidhje me faktet

e mësipërme, menyrës së përfitimit të pasurive të paluajtshme, personave me të cilët kanë kontaktuar për këto pasuri dhe çdo të dhënë tjetër që lidhet me faktet e sipërcituara.

Faqe 16

K.Pr. Penale. Në këtë rast, prokurori ose hetuesi i BKH-së, apo oficeri i policisë gjyqësore, i Gjykata urdhëron që të sekuestrohen të dhënat kompjuterike, kjo në referim të nenit 208/a të deleguar nga prokurori, të marrin masat si më poshtë:

a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash:

b) për të nxjerrë dhe për të marrë kopje të të dhënave kompjuterike:

c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet

kompjuterike me të drejetë hyrjeje: c) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.

Duke qenë se, në këto pajisje telefonike dhe elektronike (përfshirë edhe ato të shtetasve të tjerë që i nënshtrohen këtij kontrollit), mund të ndodhet edhe korrespondenca e këtyre shtetasve, gjykata lejon edhe sekuestrimin e korrespondencës, për aq kohë sa ka lidhje dhe tregon të dhëna që lidhen me faktet penale të dyshuara dhe/ose midis personave që dyshohet se janë pjesë e këtij aktiviteti të kundërligjshëm, për të dhënat që lidhen në çdo rast me këtë veprimtari të kundërligjshme, kjo në zbatim të nenit 209 të K.Pr.Penale.

Po ashtu, mbi kërkesë të organit të akuzës, dhe duke pasur parasysh veprat penale për të cilat është duke u hetuar, dinamikën e shpejtë të veprimeve të krvera, lejohet nga kjo Gjykatë edhe kontrolli dhe sekuestrimi i pajisjeve kompjuterike, si kompjuter laptop: aparate telefoni që iu përkasin shtetasve për të cilët po lejohet kontrolli nominalisht dhe po ashtu edhe i personave/shtetasve të tjerë që gjenden të pranishëm gjatë këtij kontrolli.

Po ashtu, gjykata, pasur parasysh llojin e veprave që janë duke u hetuar, të dyshuara të kryera nën një formacion të vazhdueshëm kriminal, që ka qëllimin pastrimin e produkteve të pasurive të krimit, në kushtet kur metodat e tjera hetimore nuk garantojnë marrjen e këtyre provave me të njëjtën siguri dhe vërtetësi, kontrolli i vendeve dhe ai personal mbetet mjeti i vetëm proporcional dhe efektiv për sigurimin e provave materiale, e cila është përcaktuese për zbardhjen e plotë të faktit penal si dhe individualizimin e përgjegjësisë penale për personat e dyshuar. Për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur nga Prokuroria gjendet tërësisht e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë pranohet nga gjykata.

Me ekzekutimin e vendimit për lejimin e kontrollit ngarkohen hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, në bashkëpunim me Oficerët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët çdo veprim të tyre të kryer hetimor, duhet ta dokumentojnë nëpërmjet mbajtjes së procesverbaleve përkatës.

Gjykata sjell në vëmendje të organit procedues se, kontrolli duhet të kryhet në përputhje me parashikimet ligjore të neneve 52, 204, 205 dhe 206 të K.Pr. Penale dhe në respektim të nenit 202/a, pika 4 të K.Pr.Penale, kontrolli duhet të përfundojë brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti i marrjes së vendimit për kryerjen e tij. Referuar nenit 206 të K.Pr.Penale duke pasur parasysh ngutshmërinë e veprimeve që pritet të kryhen, lejohet që kontrolli të kryhet edhe tej orareve të parashikuara nga ky nen.

Në përfundim, Gjykata, duke parë në tërësi rëndësinë e çështjes, dinamikën e veprimeve hetimore, fazën se ku ndodhet hetimi, me qëllim garantimin e hetimeve, bazuar në nenin 103 të K.Pr.Penale, urdhëron ndalimin e publikimit tërësisht apo pjesërisht të këtij vendimi gjyqësor.

Faqe 17

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 52 dhe 202-208/a, 209 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

11. Lejimin e kontrollit të vendeve dhe të personave, si më poshtë vijon:

1. Banesa e shtetasit Leonard Bishaj, i biri i Ferik dhe i Dritë, lindur më 24.03.1969 në Vlorë me nr. personal G90324083R, e ndodhur në rrugën Murat Tërbaçi, nd. 73, h. 3, ap. 19, Vlorë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin.

1.1. Kontrolli personal i shtetasit Leonard Bishaj, i biri i Ferik dhe i Dritë, lindur më 24.03.1969, në Vlorë me nr. personal G90324083R.

2. Ambient zyrë e shoqërisë "Adhenis" sh.p.k., me Nipt M066282015, e ndodhur në Vlorë, Lagija Uji i Ftohtë, Rruga Aleksandër Moisiu, Objekti ish-Kompleksi Kristal, pranë Tunelit Vlorë, Ndërtesë private një katëshe.

3. Banesa e shtetasit Pullumb Petritaj, i biri i Nexhmedin dhe i Perjana, lindur më 01.10.1964, në Vlorë me nr. personal G41001096N, e ndodhur në rrugën Ali Mesapliku, nd. 12, h. 3, ap. 1, Vlorë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin

3.1. Kontrolli personal i shtetasit Pullumb Petritaj, i biri i Nexhmedin dhe i Perjana, lindur më 01.10.1964, në Vlorë me nr. personal G41001096N;

4. Kontrolli personal i shtetasit Armalindo Petritaj, i biri i Pullumb dhe i Majlinda, lindur më 24.12.1987, me nr. personal 171224064K.

4.1. Banesa e marrë me qera nga shtetasi Armalindo Petritaj, e ndodhur në kompleksin Ambasador 3, Tiranë.

5. Banesa e shtetasit Enkes Hysendhima, i biri i Hysni dhe i Mbaresë, lindur më 21.01.1981, në Vlorë me nr. personal 110121034J, e ndodhur në rrugën Meno Gjoleka, nd. 12, h. 3, ap.1, Oriqum, Vlorë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin

5.1. Kontrolli personal i shtetasit Enkes Hysendhima, i biri i Hysni dhe i Mbaresë, lindur më 21.01.1981, në Oriqum, Vlorë me nr. personal 110121034J

6. Zyra e shtetasites Hysendhima (zyrë avokatie) e ndodhur në Lagjen Hajro Cakerri, Rr. Sulejman Delvina, në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Kt.II

Kosova, d. 18, h. 2, Lezhë, apo në çdo 7. Banesa e shtetasës Feriare Ndreu, e bija e Pullarse dhe e Majlinda, lindur më 26.09.1996, në Vlorë me nr. personal J65926078T, e ndodhur në adresë tjetër ku shtetasja ushtron efektivisht banin

7.1. Kontrolli personal i shtetasës Feriare Ndreu, me nr. personal J65926078T lindur më 26.09.1996. në Vlorë.

Faqe 18

8. Banesa e shtetasës Ina Shuraja, e bija e Pullumb dhe e Majlinda, lindur më 08.10.1993, në Vlorë me nr. personal 136008095G, e ndodhur në rrugën Brigada VIII, nd. 130, h.3, ap. 27, NJA nr.5, Tiranë, apo në çdo adresë tjetër ku shtetasja ushtron efektivisht banimin. dhe e Majlinda, lindur më

8.1. Kontrolli personal i shtetasës Ina Shuraja, e bija e Pullumb 08.10.1993, në Vlorë me nr. personal J36008095G. 22.09.1982, në Tiranë,

9. Banesë e shtetasit Redi Struga, i biri i Bujar dhe i Mirlinda, lindur më çdo adresë tjetër ku shtetasi ushtron efektivisht banimin; me nr. Personal 1209221210, e ndodhur në në Rruga Bardhyl, nd, 22, h.1. NJA 3, Tiranë apo në 9.1. Kontrolli personal i shtetasit Redi Struga, i biri i Bujar dhe i Mirlinda, lindur më 22.09.1982, në Tiranë, me nr. Personal

1209221210. ndodhur në Tiranë, Njësia bashkiake nr. 8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 10. Ambient zyre e shoqërisë "South Adriatic Development", me Nipt M12215020U, e 4, përballë Qendrës Lincoln.

III. Kontrolli të bëhet duke respektuar dispozitat ligjore të parashikuara nga nenet 52 dhe 202-208/a, 209 të Kodit të Procedurës Penale.

parashikuara nga kjo dispozitë ligjore. IV. Në zbatim të nenit 206 të K.Pr.Penale, kontrolli të kryhet edhe tej orareve të

V. Me ekzekutimin e vendimit për lejimin e kontrollit ngarkohen hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit në bashkëpunim me Oficerët e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

VI. Në zbatim të nenit 202/a, pika 4 të K.Pr.Penale, kontrolli duhet të përfundojë brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti i marrjes së vendimit për kryerjen e tij.

VII. Në zbatim të nenit 103 të K.Pr.Penale, ndalohet publikimi tërësisht apo pjesërisht i këtij vendimi gjyqësor.

VIII. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, sot më datë 31.05.2026!

GJYQTARE

FLOJERA DAVIDHI